



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembl

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione
Mbledhja nr. 10
Prishtinë, më 14.05.2012, në orën 10.00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore,
Persona të Pagjetur dhe Peticione

Në këtë mbledhje morën pjesë: Suzan Novoberdali – kryetare, Rita Hajzeraj, Kurtan Kajtazi, Biserka Kostiq, Albana Gashi, Kimete Bytyçi, Kymete Bajraktari dhe Duda Balje.

Mungoi: Justina Pula.

Nga Stafi mbështetës i Komisionit: Rrahim Demaj - koordinator dhe Sulltane Gashi - zyrtare ligjore.

Pjesëmarrës të tjerë: Elita Vokshi dhe Florijana Shala –OSBE; Visar Bivolaku-EUSR; Natyra Avdiu-YIHR; Kozeta Imami, Dren Rexha, Florije Kryeziu-UNICEF; Florije Mehmeti-KDI; Valdet Deliu, Shefqet Pajaziti dhe Rexhep Zeka- përfaqësues të fshatit Orllan; Ukë Gashi-ZPRK; Nuredin Ibishi- CDF; Burim Tahiri- praktikant; Besart Lumi-YIHR dhe Ardiana Thaçi-KTV.

Mbledhjen e kryesoi, Suzan Novoberdali- kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24 prill 2012;
3. Shqyrtimi i kërkesës për organizimin e një seance plenare lidhur me të drejtat e fëmijëve;
4. Shqyrtimi i disa kërkesave të qytetarëve;
5. Miratimi i Raportit lidhur me monitorimin e Ligjit për barazi gjinore;
6. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 24 prill 2012

Kryetarja- Njoftoi anëtarët e Komisionit se procesverbali i dt. 24 prill 2012, nuk është përkthyer ende në gjuhën serbe dhe pasi nuk është i gatshëm, të hiqet nga rendi i ditës dhe do të mbetet për miratim në mbledhjen e radhës.

3. Shqyrtimi kërkesës për organizimin e një seance plenare lidhur me të drejtat e fëmijëve

Kryetarja- Njoftoi anëtarët e Komisionit se 1 Qershori është Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve dhe tani si komision, me rregulloren e re do të kemi në fushëveprimtarinë tonë edhe mbrojtjen e fëmijëve, edhe pse edhe tani e kemi në kompetencë, sepse bën pjesë në mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Kjo iniciativë vije nga UNICEF-i dhe ne si Komision, i falënderojmë dhe e kemi parë të arsyeshme që ta mbajmë një seancë të veçantë, por paraprakisht për këtë iniciativë duhet të merret miratimi në Komision.

Kemi marrë disa rekomandime, por do t'i shtojmë edhe dy rekomandime të tjera, njëra që ka të bëjë me të drejtat e fëmijëve në përgjithësi dhe do të kemi diçka për riintegrimin e fëmijëve që vijnë nga jashtë.

Këtë material, si anëtarë të Komisionit e keni marrë me kohë në të dy gjuhët. Lidhur me këtë, hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës.

Rita Hajzeraj Beqaj- Sa i përket të drejtave të fëmijëve, nuk kemi pasur një ligj të veçantë që rregullon të drejtat e fëmijëve. Në një konferencë që është mbajtur para do kohe për të drejtat e fëmijëve nga disa OJQ, ato dolën me disa kërkesa për të drejtat e fëmijëve që të trajtohen me ligj të veçantë. Ne duhet të kërkojmë nga Qeveria, që për një kohë të shkurtër, të hartohet një ligj i veçantë për të drejtat e fëmijëve. Sa i përket shënimit të 1 Qershorit- Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, unë konsideroj se duhet kërkuar si Komision, që 1 Qershori të shënohet me një debat parlamentar në Kuvendin e Kosovës, duke pasur parasysh që të drejtat e fëmijëve shkelen dita- ditës. Shumë të rinj dhe të reja punojnë punë jashtëzakonisht të rënda për të mbajtur familjen, ose shtyhen

nga persona të tretë për të punuar, për t'i plotësuar nevojat financiare dhe i keqpërdorin fëmijët në moshë shume të re.

Kryetarja-Tha se të drejtat e fëmijëve janë të rregulluara me kodin për të mitur, i cili është miratuar në vitin e kaluar. Ajo tha se jam plotësisht e pajtimit për të mbajtur një seancë të veçantë për të shënuar 1 Qershorin- Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, ndërsa si Komision, të dalim me rekomandime, dhe për këtë iniciativë falënderoi UNICEF-in.

Kurtan Kajtazi- Duke u ndërlidhur me parafolesit, tha se e përkrahi mbajtjen e një debati parlamentar, ndërsa sa u përket të drejtave të fëmijëve, debati të jetë para ose më 1 qershor, kështu që mos të kalohet data 1 qershor, ndërsa sa u përket rekomandimeve, ne mund të diskutojmë dhe mund të plotësojmë edhe me ndonjë rekomandim tjetër.

Kryetarja - Pas debatit, propozoi që për këtë çështje të votohet për propozimin e mbajtjes së një seance për të shënuar 1 Qershorin - Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve.

Përfundim

Komisioni, unanimisht vendosi që me një shkresë t'i drejtohet Kryesisë së Kuvendit me kërkesën për mbajtjen e një seance parlamentare, më 1 Qershor për të shënuar Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, ndërsa nëse nuk ka mundësi të mbahet më 1 qershor, mundësisht të mbahet para datës 1 qershor 2012.

4. Shqyrtimi i disa kërkesave të qytetarëve

Kryetarja- Njoftoi anëtarët e Komisionit se janë dy kërkesa të qytetarëve, të adresuara për shqyrtim në Komision, duke shtuar se për shqyrtimin e kërkesave dhe peticioneve kemi autorizuar grupin e punës, i cili paraprakisht i shqyrton dhe bën prezantimin e tyre para Komisionit. Gjithashtu, ne kemi këtu prezent edhe parashtruesit e kërkesës së banorëve të fshatit Orllan të Komunës së Podujevës.

Rita Hajzeraj- Lidhur me shqyrtimin e kërkesave, tha se kemi pasur për shqyrtim tri kërkesa. Sa i përket kërkesës së parë, kemi prezent edhe palën nga fshati Orllan i Komunës së Podujevës, të cilët janë ankuar për mosfurnizim me ujë dhe disa ankesa të tjera që do t'i dëgjojmë drejtpërdrejt nga vet ankuesit e fshatit dhe të dëgjojmë se a kanë bërë kërkesë në Komunë dhe si janë përgjigjur, ku është problemi.

Ndërsa, kërkesa e dytë është e banorëve të Obiliqit dhe tashmë dihen ankesat e tyre për ndotjen e ambientit. Ata kërkojnë nga ne si Komision që të ndërhyjmë në ndryshimin e shumë ligjeve të miratuara nga Kuvendi i Kosovës. Ne, si Komision, jemi të thirrur të bëjmë vetëm rekomandime ndaj komisioneve të caktuara dhe ndaj Kryesisë së Kuvendit dhe nuk jemi kompetent të bëjmë ndryshime apo plotësime të atyre ligjeve që nuk janë në kompetencë të këtij Komisioni. Sa i përket kërkesës së tretë, është kërkesa e UNICEF-it për të drejtat e fëmijëve dhe për këtë u diskutua më herët.

Kryetarja-Falënderoi anëtarin e Komisionit, deputeten Rita Hajzeraj për prezantimin e përmbajtjeve të kërkesave dhe fjalën ua dha përfaqësuesve të fshatit Orllan.

Shefqet Pajaziti, përfaqësues i fshatit Orllan - Së pari falënderoi anëtarët e Komisionit për ftesën dhe për shqyrtimin e kërkesave të fshatit dhe tha se fshati Orllan me rrethinë ka përmbi 2000 banorë dhe se këta banorë qysh moti kanë probleme me furnizim me ujë dhe furnizohen vetëm nga puset apo bunarët, të cilëve mostrat që u janë bërë rezultojnë se shumica e këtij uji është i papijshëm. Në këtë rajon, këtë ujë e përdorin Komuna e Podujevës, Komuna e Prishtinës, e Fushë – Kosovës, e Lipjanit, e Obiliqit dhe kompania e KEK-ut.

Ne si rajon, jetojmë në një vend ku ka ujë të mjaftueshëm dhe na janë shkelur të drejtat elementare për shfrytëzimin apo për të qenë shfrytëzues të këtij uji. I kemi ndërmarrë të gjitha veprimet në nivelin lokal dhe atë qendror dhe ju kemi drejtuar dhe ofruar dy projekte vitale që janë për këtë vend, bëhet fjalë për projektin e ujësjellësit dhe projektin e kanalizimit dhe të gjitha këto projekte janë bërë me kontributin e banorëve.

Këto projekte i posedon që nga vitit 2005 AER-i, Komuna e Podujevës, Ministria e Infrastrukturës, Ministria e Ambientit dhe Ujësjellësi rajonal “Prishtina”. Komuna e Podujevës nga buxheti i Kuvendi Komunal, në vitin 2005 i ka ndarë 40 000 mijë euro për fshatin Orllan, për gropa skeptike dhe këto nuk janë investuar në Orllan. Ata e dinë këtë se ku janë shfrytëzuar. Ne deri më tani nuk kemi pasur asnjë ndihmesë në këtë drejtim dhe nga viti 2005 ne kemi përsëritur kërkesat disa herë në Kuvendin Komunal të Podujevës, por edhe institucionet qendrore. Në vitin 2011 kërkesat tona dhe nënshkrimet tona ia kanë dërguar Kuvendit të Kosovës, Qeverisë së Kosovës, Kuvendit Komunal Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, Ujësjellësit rajonal “Prishtina”, Zyrës Civile Ndërkombëtare të Pieter Feith-it, Ambasadës Amerikane dhe USAID-it, ndërsa nuk kemi marrë asnjë përgjigje nga asnjëra nga këto.

Ne kërkojmë nga ju që me konsideratë ta merrni kërkesën tonë, sepse është shkelje esenciale që të na ndalohej shfrytëzimi i ujit.

Kryetarja- Ne si Komision duhet bërë disa kërkesa për çështjen tuaj dhe duhet drejtuar apo eventualisht duhet bërë një vizitë kryetarit të Komunës së Podujevës dhe të dimë pse nuk është rregulluar kjo çështje, ky është propozimi im.

Rita Hajzeraj-Më vjen keq që asnjë institucion deri më tani nuk është përgjigjur, meqenëse ju konsideroni se kjo është shkelje e të drejtave të njeriut, atëherë ne si Komision do të hulumtojmë çështjen se çka është në pyetje, mos kanë ndonjë arsye pse nuk kthehen përgjigjet. Unë jam dakord ose të ftohet kryetari i Komunës së Podujevës, ose të shkojmë ne si Komision në terren dhe të njoftohemi me gjendjen reale, sepse ne, njëherë palë po e dëgjojmë, por jo edhe palën tjetër. Kur të merren informacionet nga të dy palët, atëherë mund të dalim me një përfundim si Komision ashtu si na takon. Bëri pyetje për përfaqësuesit e fshatit Orllan: Sa vite nuk keni ujë?

Shefqet Pajaziti, përfaqësues i fshatit Orllan- Sa i përket pyetjes së deputetes Rita Hajzeraj, tha se si fshat nuk kemi qenë të kyçur asnjëherë në rrjetin e ujësjellësit të liqenit të Batllavës.

Kurtan Kajtazi- Tha se sa i përket kërkesës së banorëve të fshatit Orllan, si Komision dëgjuam problemet e tyre dhe pas kësaj që dëgjuam, do ta analizojmë mirë, meqenëse me

Ligjin për qeverisje lokale është obligim që këto shërbime komuna t'ua ofrojnë qytetarëve, por nëse është kosto e lartë buxhetore duhet bërë kërkesë shtesë në kuadër të Qeverisë për t'iu ndihmuar komunave. Lidhur me këtë, ne do ta takojmë edhe kryetarin e Komunës së Podujevës dhe do të bisedojmë për zgjidhjen e këtij problemi që ju e keni me vite.

Bëri pyetje: Si rajon, ato fshatra a i takojnë vetëm Komunës së Podujevës apo edhe Komunës së Prishtinës dhe a ekziston rrjeti i vjetër i ujësllësit?

Shefqet Pajaziti, përfaqësues i fshatit Orllan- Tha se rajoni i Orllanit i ka dymbëdhjetë fshatra, të gjitha gravitojnë në Komunën e Podujevës. Nuk mund të jem i sigurt se a ka pasur më herët, por tani nuk kemi.

Kryetarja- Falënderoi përfaqësuesit e fshatit për pjesëmarrje në mbledhje. Ne u informuam hollësisht me problemet që ballafaqohen, ne si Komision do të marrim një vendim sesi do të veprojmë për këtë dhe do të mundohemi që t'ju japim përgjigje këtyre banorëve.

Rita Hajzeraj- Bëri prezantimin e kërkesës së dytë, e cila ka të bëjë me shqetësimet banorëve të Obiliqit, ku kërkohet që të ndërhyjmë për ndryshimin e projektligjeve, gjë që nuk është kompetencë e Komisionit për të Drejtat e Njeriut. Ne, si Komision, është mirë që t'i ftojme dhe t'i dëgjojmë problemet e tyre dhe të shohim çka mund t'ju ndihmojmë. Ata kërkojnë edhe disa benificione të tjera që faturat e rrymës t'i kenë 50% më lirë sesa qytetarët e komunave të tjera. Të ftojme Komisionin për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, dhe ministrinë përkatëse dhe të shohim se çka është ndërmarrë lidhur me zgjidhjen e këtyre kërkesave.

Albana Gashi- Duke u ndërlidhur me kërkesën, tha se pajtohet me mendimin e Rita Hajzerajt, pra që të ftohen palët dhe të dëgjohen nga Komisioni dhe të kemi përgjigje nga të gjitha palët.

Kryetarja- Sa i përket kërkesës së banorëve të Obiliqit, tha se tani e kemi një kërkesë dhe mendon se për momentin është herët të ftohet ministria dhe organet përgjegjëse, fillimisht është mirë që të ftohen parashtruesit e kërkesës dhe të dëgjohen, e pastaj të marrim vendim se çka të ndërmarrim më tutje.

Rita Hajzeraj- Tha se e kemi kërkesën e tyre dhe mendon që të ftohet ministria përkatëse dhe ta dimë se cilat janë planet e kësaj ministrie për atë zonë të caktuar.

Kymete Bajraktari -Duke u ndërlidhur me kërkesën në fjalë, tha se është e mendimit që të ftohen të gjitha palët përnjëherë, në mënyrë që të mos zgjatet procedura dhe për këtë të kemi një pasqyrë më të mirë.

Kryetarja- Tha se është e pajtimit që të ftohen përfaqësuesit e ministrisë përkatëse, por pas dëgjimit të parashtruesve të kërkesës, të ftohen ndaras, pra pas sqarimeve që do t'i marrim nga përfaqësuesit e kërkesës.

Sa i përket kërkesës për ndryshim të ligjeve që janë në fuqi, ne, në bazë të asaj shkrese, duhet që me një shkresë nga Komisioni të njoftohet Kryesia dhe komisionet tjera përgjegjëse që janë për ndryshimin e atyre ligjeve.

Rita Hajzeraj- Tha se, ne nuk mund ta dimë gjendjen reale, nëse nuk i ballafaqojmë palët që janë të ndërlidhura me këtë kërkesë.

Kurtan Kajtazi- Ne nuk e kemi vendimin e Kuvendit të Kosovës që e ka shpallur 70% të territorit të Obilikut zonë me interes të veçantë. Disa kërkesa të tyre janë të ligjshme dhe të arsyeshme, e disa janë të papërbalueshme për buxhetin. Ne duhet të marrim sqarime nga palët duke i dëgjuar veç e veç.

Kryetarja-Meqë kemi një kërkesë të qartë se çka kërkohet, unë propozoj që të thërrasim ministrinë përkatëse dhe të kërkojmë sqarime nga ata, e nëse kemi paqartësi, atëherë e thërrasim edhe palën tjetër, pra nëse është e domosdoshme, bëjmë ballafaqimin e palëve, por njëherë është e panevojshme që të ftojme të dy palët.

Kryetarja- Meqë kemi dy propozime, pra që të ftohen përfaqësuesit e kërkesës dhe përfaqësuesit e ministrisë së bashku dhe propozimin që njëherë të ftohen përfaqësuesit e institucioneve përkatëse dhe pastaj përfaqësuesit e kërkesës së banorëve të Obilikut.

Komisioni votoi për propozimet dhe votat mbeten baras, 4 me 4.

Kryetarja-Në bazë të këtij votimi, të kërkohet interpretim nga zyra ligjore dhe në bazë të saj të merret vendim.

5. Miratimi i Raportit lidhur me monitorimin e Ligjit për barazi gjinore

Kryetarja-Në pika të shkurtra njoftoi Komisionin me kronologjinë e monitorimit të Ligjit për barazi gjinore. Kemi pasur vetëm një ditë vizite, në mënyrë elektronike kemi shpërndarë pyetësorët në të gjitha institucionet përkatëse. Kemi marrë përgjigje, ende nuk e kemi marrë raportin final, por shumë shpejt do të jetë gati, sepse është punuar mjaft shumë.

Nga anëtarët e Komisionit, Albana Gashi dhe Rita Hajzeraj pati vërejtje rreth ecurisë së monitorimit të këtij Ligji.

Kurtan Kajtazi- Si Komision, është mirë që të realizojmë raportin, pra të dalim me rekomandime të harmonizuara.

Rita Hajzeraj- Propozoi që të mbahet një dëgjim publik përmbyllës, të ftohen aktorët që kanë dërguar informatat dhe pastaj, ne, si Komision, të nxjerrim rekomandimet.

6. Të ndryshme.

Kryetarja- Njoftoi se komisionet kryesore kanë shqyrtuar raportin me amendamente në Projektligjin për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër. Komisioni për Buxhet dhe Financa ka bërë dy propozime, gjithashtu edhe Komisioni për Legjislacion ka bërë disa propozime.

Komisioni vendosi që raportet nga komisionet kryesore dhe amendamentet e propozuara, të shpërndahen për të gjithë anëtarët e Komisionit dhe në mbledhjen e radhës do të shqyrtohen, do të harmonizohen dhe do të procedohen për miratim në seancë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:45.

E përgatiti: Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetarja e Komisionit

Suzan Novoberdali